



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA VLADA GOVERNMENT	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE, TEHNOLOGJE I INOVACIJE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE TECHNOLOGY AND INNOVATION	
Nr./Br./No. <u>5/2457</u>	DALJE
	Data/Date/Datë <u>26.9.25</u>
Nr. Çfaq./Br. sh./No. fq. <u>4</u>	
Prishtinë / Priština / Pristina	

Datë: 26-09-2025

Nr. 5/2457

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesa nr. 5/2457 të datës 15.07.2025 të parashtruar nga BPrAL- "UBT", nxjerr:

V E N D I M

Për licencimin dhe rilicencimin e Kolegjit "UBT"

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji "UBT" në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (5) pesëvjeçare 2025-2030 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), në kampusin kryesor në Prishtinë sipas vendimit të AKA-s 2573/24 datë: 18.12.2024.
2. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji "UBT" në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (5) pesëvjeçare 2025-2030 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), sipas vendimit të AKA-s 714/25 datë: 20.06.2025 me programin e studimit:
 - 2.1. Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.
3. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji "UBT" në Prishtinë, licencohet për periudhën (3) trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), me programet e studimit:
 - 3.1. Dizajn, BP 180 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - 3.2. Dizajn i Modës BP 180 ECTS me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;
 - 3.3. Shkenca Politike, MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - 3.4. Studime të Sigurisë, MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.

4. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (5) pesëvjeçare 2025-2030 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), sipas vendimit të AKA-s nr. 582/25 datë: 27.05.2025, me programet e studimit:

- 4.1. Inxhinieri e Makaronikës, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;
- 4.2. Stomatologji, Dr Dent 360 ECTS me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik;
- 4.3. Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- 4.4. Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.

5. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën (3) trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), me programet e studimit:

- 5.2. Inxhinieri e Mekatronikës MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- 5.3. Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;
- 5.4. Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 100 studentë për vit Akademik;
- 5.5. Biokimi Mjekësore, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- 5.6. Shkenca Paramjekësore MSc 120 ECTC me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- 5.7. Teknik i Radiologjisë, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.

6. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” në Prishtinë, licencohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), me programet e studimit:

- 6.1. Shëndet Publik dhe Shkenca Mjekësore, BSc 180 me kuotën maksimumi 70 studentë për vit Akademik;
- 6.2. Kimi aplikative, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- 6.3. Psikologji, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- 6.4. Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës, BA 180 ECTS me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik.

7. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” në Prishtinë, licencohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA-s nr. 448/25 datë: 23.04.2025 me programin e studimit:

- 7.1. E drejta tregtare LLM 60 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.

8. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” në Prishtinë, licencohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA-s nr. 847/25 datë: 07.07.2025 me programet e studimit:

- 8.1. Trafiku dhe Inxhinieria e Transportit, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 35 studentë për vit Akademik;
- 8.2. Arte Dramatike, BP 180 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik

9. Bartësi privat i Arsimit të Lartë / Kolegji “UBT” dega në Ferizaj, rilicencohet për periudhën pesëvjeçare 2025-2030 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), sipas vendimit të AKA-s nr. 584/2 datë: 27.05.2025 me programin e studimit:

9.1. Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 90 studentë për vit akademik.

10. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “UBT” dega në Prizren, licencohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA-s nr. 593/25 datë: 27.05.2025 me programin e studimit:

10.1. Dizajn, BP 180 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.

11. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr.5/2457 të datës 15.07.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “UBT”, dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim si në vijim: vendimi me nr. ref. 2573/24 e dt. 18.12.2024, vendimit me nr. ref. 448/25 e dt. 23.04.2025, vendimit me nr. ref. 528/25 e dt. 27.05.2025, vendimit me nr. ref. 714/25 e dt. 20.06.2025, vendimit me nr. ref. 584/25 e dt. 27.05.2025, vendimit me nr.ref. 593/25 e dt. 27.05.2025 dhe vendimit me nr. ref. 847/25 e dt. 07.07.2025.

Licenca e Kolegji “UBT”, zgjat sipas dispozitivit të këtij vendimi si në nivel institucional dhe të programeve të studimit duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim në Qendrën në Prishtinë, degën në Ferizaj dhe Prizren, ka konstatuar që Kolegji “UBT” brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj vendimin për ndryshim të destinacionit në qendrën në Prishtinë nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organi kompetent Drejtoria e Urbanizmit - Komuna e Prishtinës.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk e sjellë vendimin për ridestininim nga organi kompetent - Drejtoria e Urbanizmit, për Kolegjit “UBT” me Qendrën në Prishtinë, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Për objektin në Ferizaj, Kolegjit UBT i kërkohet që në shtator të vitit 2026, të ofroj hapësirë tjetër dhe të destinuar për arsim, ndryshe në hapësirat që tani i shfrytëzon nuk i lejohet vazhdimi i regjistrimit të studentëve nga shtatori i vitit 2026, (objekti i tanishëm nuk i plotëson kriteret e kërkuara për shfrytëzim).

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit “UBT”;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

